



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 19.11.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyçi, Justina Pula dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Suzan Novobërdali Albana Gashi dhe Duda Balje.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi - zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Te ftuar: Shehrije Leci-MAP, Naser Shanolli-MAP, Afrim Maliqi-Handikos dhe Xhemile Murseli-Handikos.

Pjesëmarrës të tjerë: Nevahir Hazeri-KDI, Ukë Gashi-ZPRK, Elita Vokshi, Floriana Shala-OSBE, Florije Kryeziu-UNICEF dhe Visar Bivolaku- EU OFFICE-EURS.

Mbledhjen e kryesoi, Biserka Kostiq- zëvendëskryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 12 nëntor 2012,
3. Raportimi i ministrave rreth nxjerrjes së akteve normative në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar,
4. Shqyrtimi i kërkesës së IAP-it,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja- Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që pika e 4-të, të hiqet nga rendi i ditës.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 12 nëntor 2012.

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur, më 12 nëntor 2012.

3. Raportimi i ministrave rreth nxjerrjes së akteve normative në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara,

Kryesuesja- lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se janë ftuar ministrat, të cilët janë përgjegjës për nxjerrjen e akteve normative, në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu, kemi ftuar edhe drejtorin e Handikosit, z. Afrim Maliqi, i cili edhe më parë na ka informuar lidhur me vështirësitë që i hasin personat me aftësi të kufizuara si dhe personat me paraplegjik dhe tetraplegjik.

Ajo, tha se kërkesa për raportim i është dërguar Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Administratës Publike. Këto ministri, deri më tash nuk i janë përgjigjur ftesës, me përjashtim të Ministrisë së Administratës Publike.

Konsideroj se kjo kategori e shoqërisë është e diskriminuar, pikërisht për shkak të natyrës së sëmundjeve nga të cilat ata vuajnë. Ajo tha se për ministrinë që nuk janë përgjigjur, do të bëhen disa pyetje, ndërsa fjalën ia dha përfaqësuesit të Ministrisë së Administratës Publike.

Shehrije Leci- Udhëheqëse e Divizionit të Departamentit Ligjor në MAP, duke u ndërlidhur me kushtet e personave me aftësi të kufizuara, tha se nuk jemi në dijeni për udhëzimin administrativ, të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që janë të obliguara të gjitha institucionet që të zbatojnë atë udhëzim. Është dashur të bëhet një debat publik dhe të informohemi se në cilat vende kanë mundësi që këta persona të integrohen.

Kryesuesja-tha se i intereson të dijë, a ka nëpër institucione persona të punësuar me aftësi të kufizuara, pa marrë parasysh kuotën ligjore.

Naser Shanolli -tha se për informacionet që ju shtruat pyetje, është kompetent një departament tjetër në kuadër të ministrisë dhe ne mundemi juve t'ua sjellim me shkrim, pasi që ato ekzistojnë, por tash për tash nuk i kemi ato informacione.

Kryesuesja- duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se do të ishim mirënjohës, nëse kjo ministri na i përcjell ato të dhëna.

Rita Hajzeraj- duke u ndërlidhur, tha se “me herët u tha se nuk jemi në dijeni rreth kuotës, në sa të punësuar duhet të jetë një person me aftësi të kufizuara. Ministrinë duhet të jenë të informuara me ligjet, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Kosovës”.

Shehrije Leci-tha se kuota është e përcaktuar në ligj. Nuk kemi paqartësi asgjë, sa i përket ligjit, por unë nuk jam në dijeni rreth aktit nënligjor që është e obliguar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me nxjerrë dhe të caktojë, se në cilat vende kanë mundësi të punojnë këta persona, dhe të na ofrojnë, në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil.

Rita Hajzeraj- tha se Ligji i Punës e përcakton se sa duhet të jetë shkalla e aftësisë së kufizuar e një personi, që të mund të jetë i punësuar në një vend të caktuar.

Kryesuesja- tha se një person me aftësi të kufizuara, nëse ka aftësi psikike, mund t'i kryej të gjitha punët administrative brenda zyrës. Nuk është mirë të prejudikohet se çka munden, e çka nuk munden këta persona të punojnë.

Kurtan Kajtazi- Meqenëse prezentë këtu është vetëm Ministria e Administratës Publike, po diskutojmë për Ligjin për Aftësim dhe Riaftësim Profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj i rregullon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, për aftësim e riaftësim të këtyre personave. Neni 12, i këtij ligji thotë se organet e administratës shtetërore, sektori publik, privat si dhe organizatat joqeveritare obligohen që në kushte të përshtatshme të punës, të punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuar, në çdo 50 punëtorë. Ministria e Administratës Publike ka pasur për detyrë të nxjerrë aktet nënligjore dhe të bëjë rregullimin e zbatimit të nenit 12, të këtij ligji.

Naser Shanolli -duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se ky është një obligim që i përket Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ne kemi për obligim të zbatojmë Ligjin për Shërbimin Civil.

Rita Hajzeraj- tha se Ligji i Punës e saktëson që të formohet grupi i doktorëve, i cili e vlerëson shkallën e varësisë së personit në fjalë. Në momentin që ai person konkurren për një vend pune, dhe konsideron se në bazë të shkallës së caktuar është i aftë për atë vend të punës, sepse Ligji i Punës e përcakton këtë. Ju e dini se rrallë ndonjë institucion iu ofron kushte këtyre personave për qasje sepse ju mungon infrastruktura.

Justina Pula- tha se si komision, “jemi të interesuar për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara. Propozoj që ministrisë t'i jepet një afat në mënyrë që të na sjellin të gjitha të dhënat, se cilat ministri kanë qasje për kushtet e këtyre personave, dhe të dhënat, se cilat institucione kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara dhe sa është numri i tyre. Neve na duhet një bazë e të dhënave, për të bërë kërkesa dhe ndryshime, apo për të nxjerrë ndonjë akt i ri për këta persona”.

Afrim Maliqi- duke u ndërlidhur me parafolësit, tha se punësimi për këta persona është një çështje mjaft komplekse, dhe institucionet ende nuk kanë treguar gatishmëri për zbatimin e ligjit.

Ligji ekziston, por udhëzimin administrativ, me sa ne jemi të informuar, duhet ta nxjerr Ministria e Administratës Publike. Sa i përket qasjes, ekziston udhëzimi administrativ, i cili thotë se “çdo objekt publik, duhet të ketë kushte për qasje për personat me aftësi të kufizuar”, ku kuptohet që edhe një kioskë më i thjeshtë, duhet të ketë qasje për këta persona, që një gjë e tillë nuk ndodh tek ne”.

Ai tha se nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është mbështetur me nga 45 euro, tani më me diçka më shumë, ndërsa familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, i marrin nga 100 euro.

Ndërsa, sa i përket kërkesës së Komisionit, për nismën e nxjerrjes së Ligjit për Paraplegji dhe Teraplegji, kemi informata se Zyra për Qeverisje të Mirë, deri me tani, ende nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim dhe do të mbetet ende kështu.

Kryesuesja- tha se “po me vjen keq që këtu nuk janë prezent përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, pasi që përgjegjësia më e madhe ju takon atyre, për këto çështje. Duhet të bëhet një shkresë dhe të kërkohet prej tyre, pse nuk kanë ardhur dhe e mbështes propozimin e zonjës Justina Pula, që të informohemi përmes raportit me shkrim nga Ministria e Administratës Publike, për përgjegjësitë që i ka kjo ministri, lidhur me këta persona dhe informatat për këta të punësuar”.

Kurtan Kajtazi- duke u ndërlidhur, tha se “kam një propozim që të kërkohet me shkrim, që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të vijë në takim në mbledhjen e ardhshme dhe të na informojë rreth nxjerrjes së akteve nënligjore, për nenin 13, nenin 13.7 dhe 13.8, të Ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuara dhe nenin 12, të Ligjit për Aftësim dhe Riaftësim Profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu duhet të ftohet edhe Zyra për Qeverisje të Mirë dhe të gjitha çështjet e ngritura për këta persona t’i diskutojmë bashkërisht.

Kryesuesja-tha se pajtohet me propozimet e Justina Pulës dhe Kurtan Kajtazit dhe se për këto, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni të kërkojë nga Ministria e Administratës Publike, se cilat Ministri kanë qasje për kushtet e këtyre personave, dhe të dhënat, se cilat institucione kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, sa është numri i tyre. Gjithashtu, duhet të ftohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mbledhjen e ardhshme, të na informojë rreth nxjerrjes së akteve nënligjore, për nenin 13, nenin 13.7 dhe 13.8, të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe nenin 12, të Ligjit për Aftësim dhe Riaftësim Profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, rreth hartimit të Ligjit për Paraplegji dhe Tetraplegji.

5. Të ndryshme.

Kryesuesja-njoftoi se Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur, ka ftuar anëtarët e komisionit në një konferencë, në orën 15:00, në ndërtesën e Qeverisë, dhe tha se është mirë dikush nga anëtarët e Komisionit të marrë pjesë në atë takim.

Kymete Bajraktari-duke u ndërlidhur, tha se më 30 gusht, është premtuar ndërtimi i obeliskut për persona të pagjetur. Unë jam e interesuar të kërkojë informatë, se në cilën fazë është procedura e ndërtimit të këtij obelisku.

Ajo, gjithashtu tha, se Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur ka bërë një vizitë në Qipro dhe në Gjermani, ku kanë pasur disa takime. Unë jam e interesuar, që ata të na informojnë se çka është biseduar në ato takime.

Kryesuesja-tha se pajtohem që të bëhet një kërkesë e tillë dhe administrata ta kryej këtë detyrë.

Kimete Bytyçi- njoftoj Komisionin, se Grupi Punues për të Drejtat e Fëmijëve, do të bëjë një vizitë në Fushë- Kosovë, në komunitetin RAE, si dhe në Qendrën e Familjeve Strehuese. Ajo tha, se vizita do të bëhet më 20 nëntor 2012, ndërsa nisja do të bëhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në orën 10:45.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novobërdaliu